



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCES**

**Njoftim për shtyp**

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G””

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e fundit shqyrtoi informacionin mbi procesin e dhënies së licensës së parë për shërbimin e teknologjisë me bazë të gjerë “3G” mbështetur në Ligjin 9121 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, ndryshuar me ligjin 10317, datë 16.09.2010, ku në objektin e ligjit janë përfshirë edhe ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave u janë dhëna nga shteti **të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta**.

Autoritetit të Konkurrencës ka administruar informacionin e ardhur me shkresën nr. 365/1, datë 01.10.2010 nga AKEP, lidhur me informacionin dhe dokumentacionin përkatës mbi procedurat e ndjekura për dhënien e të drejtës së përdorimit të brezit UMTS si dhe propozimin që AKEP i ka bërë Ministrit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit lidhur me kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz.

Në analizën e tregut të telefonisë celulare, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se ka patur dinamikë të lartë ndryshimesh si në pjesët e tregut ashtu dhe numrin e përdoruesve. Në tregun e telefonisë celulare e ofrojnë shërbimin 4 kompani AMC Sh.A, Vodafone Albania Sh.A, “Eagle Mobile” dhe “PLUS”. Në garën për licensën e parë morrën pjesë vetëm 2 kompani, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, ku fitues për ofertën më të mirë u shpall Vodafone Albania.

Lidhur me monitorimin e tregut të shërbimeve me bazë të gjerë, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se tregu përkatës i produktit i përcaktuar në licencën 3G është *e drejta e përdorimit në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër, i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë*.

Sipas analizës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, numri maksimal i mundshëm i frekuencave është katër dhe nuk ka ende një afat kohor për dhënien e licensave të tjera. Sipas MITIK, Autorizimi Individual për 3G e parë do të jetë i vetmi në funksionim për një kohë të shkurtër.

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kujdeset për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke ndaluar çdo sjellje që përbën abuzim me pozitën dominuese dhe për këtë arsye vlerëson se dhënia e një licence të vetme qoftë edhe për një periudhë të shkurtër kohe përbën një **kufizim** të konkurrencës mes operatorëve për ofrimin e shërbimit në tregun përkatës.

Për arsyet më lart, Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit liberalizimin e tregut të shërbimit të 3G, duke dhënë licencat e tjera për këtë shërbim, sa më parë që të jetë e mundur. Këto licenca të jepen në të njëjtën kohë në mënyrë që të rritet konkurrenca e lirë dhe efektive në këtë treg për shërbimin “3G”. Kushtet e dhënies së këtyre licencave duhet të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në licencën e parë të akorduar.

Komisioni vendosi gjithashtu t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare rregullimin e tregut të shërbimit të teknologjisë me brez të gjerë mbi baza të metodologjive transparente dhe të rregullojë tarifat e shërbimit të orientuara drejt kostos.